



Npi – 01/179 datë: 29.05.2024

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008, Kuvendi, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/456 të datës 22.05.2024, si dhe Rekomandimin e MAPL-së Nr.020-256-11-2024 të datës 30.04.2024, në seancën e mbajtur më 29.05.2024 miratoi këtë:

## V E N D I M

### PËR NDRYSHIMIN E BAZËS LIGJORE TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES Npi-01/119 TË DATËS 28.03.2024

#### I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -V- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 29.05.2024, me shumicën e votave miratoi vendimin për ndryshimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes me numër Npi-01/119 të datës 28.03.2024 për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë nga Kryqi Kuq i Kosovës – Dega në Shtime, në Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-02148-10. Zona Kadastrale – Shtime. Me sipërfaqe prej 1000m<sup>2</sup>. Kualiteti - Mal i klasës së dytë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit të Komunës Shtime – Shfrytëzues Kryqi Kuq i Kosovës, Dega në Shtime, ndryshimi është te baza ligjore si vijon:

- ( Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008 ).

#### II

A r s y e t i m: Komuna e Shtimes me vendimin Nr.01/6/3867 të datës 25.11.2005 i ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm Kryqit të Kuq të Kosovës – Dega në Shtime, sipërfaqen e tokës prej 1000m<sup>2</sup> (10 ari) në Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-02148-10, në Zonën Kadastrale – Shtime, për nevoja të objektit të administratës, por që nuk është ndërtuar deri më tani. Duke marrë për bazë Marrëveshjen Nr.02/354 të datës 27.10.2022, të Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB) dhe Komunës së Shtimes për Bashkëfinancim dhe Realizim të Projektit "Ndërtimi i Objektit të Komunës së Shtimes" në vlerën totale 2.5 milion euro, të cilat janë buxhetuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës, është paraqitur nevoja për sigurimin e lokacionit, meqenëse Komuna e Shtimes nuk posedon paluajtshmëri e cila i plotëson kushtet për ndërtimin e objektit të ri të administratës, atëherë, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit, sipas dispozitivit të këtij vendimi. Ndryshimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/119 të datës 28.03.2024 është rekomanduar nga MAPL - Nr.020-256-11-2024 më datën 30.04.2024 për arsye se ka qenë e shkruar si vijon:

"Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Ligji Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008".

#### III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

#### IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit

Adnan Ademi